

# MANIFESTI I GJELBER



## **Vizioni ynë**

### **Ideja jonë themelore ka pikënisjen nga katër solidaritetet:**

- Solidaritet me llojet, natyrën dhe sistemin ekologjik.
- Solidaritet me gjeneratat e ardhshme
- Solidaritet me popujt e botës.
- Solidaritet me popullin e vendit tonë.

Vizioni i Partisë së Gjelbër është një shoqëri e qëndrueshme ekologjike dhe sociale ku ndërgjegjshmëria, solidariteti dhe liria bashkohen.

Partia e Gjelbër është një lëvizje që princip të politikës së saj ka një zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri, një mënyrë zhvillimi që respekton të drejtat e njeriut, lirinë, drejtësinë, barazinë, demokracinë, paqen dhe ngre bazat e përgjegjësisë për mjedisin

### **Lëvizja jonë politike shtrihet në disa fusha sociale :**

- aktivitete mjedisore dhe anti-nukleare,
- një politike të paqes kundër dhunës dhe konflikteve,
- zhvillimin e lëvizjeve feministe, të cilat luftojnë për një barazi të vërtetë ndërmjet burrit dhe gruas;
- lëvizjet për liri dhe për të drejtat e njeriut që luftojnë kundër regjimeve totalitare;
- lëvizjet për drejtësi sociale dhe solidaritet

## **1.Për një Shqipëri të Gjëlber**

Partia e Gjëlber është një parti e re.

Ne udhëhiqemi nga mendime, ide dhe vlera të një epoke të re kohore,për shekullin e njëzet e një.Ne mendojmë globalisht, veprojmë në mënyrë lokale dhe ne duam që gjurmët që lëmë pas të mos jenë shkatërimi dhe varfëria. Ne jemi të bindur se ka mundësi që të krijohet një shoqëri të qëndrueshme ekologjike dhe sociale për njerëz që duan të jetojnë,dashurojnë, rriten dhe të guxojnë.

Partia e Gjëlber kërkon rrugë të reja zhvillimi.

Në këtë program të partisë sonë, ne kemi pasqyruar pëshkrimin e realitetit, vizionet dhe rrugët për të ardhmen që kërkojnë vullnet për ndryshime, përmirësime dhe progres.

Të gjitha idetë e reja ndeshen me mendimin që ;kjo është e pamundur dhe e pabarazueshme. Ka shumë vetë që pohojnë kështu.

Ne themi:Asgjë nuk është e pamundur! Ne mundemi nëse duam!

**NE DUAM!**

**NËSE DHE JU DONI?**

**MIRË SE VINI TE NE!**

**Bashkarisht mundë të realizojmë atë që të tjerët thonë se është e pamundur!**

**Një botë për të jetuar në të, një jetë për t'a jetuar,një ardhme për t'a besuar.**

## **2.Për një mjedis të shëndetshme**

Të Gjëlberit e shikojnë qenësine e tyre të lidhur ngusht me mjedisin.Nuk mund te kuptohet mirëqenia ekonomike e propozuar nga partite e tjera,pa siguruar me parë një mjedis të shëndetshëm për ne që jetojme sot dhe për të ardhmen e femijëve tane.

Ne jetojmë në një territor të zhveshur nga erozioni dhe të mbuluar nga betoni, jetojmë në zona të pyllëzuara pa pyje, duke thithur ajrin që shkakton kancer, jetojmë me ndotjen e ujit dhe tharjen e burimeve.Ne po jetojmë pa bukurinë e lagunave, lumenjëve, deteve dhe bukurive të tjera natyrore. Po jetojmë pa shumëllojshmërinë e bimëve ,kafshëve, shpendëve ,peshqëve të cilët rriteshin më parë së bashku me ne. Ne po jetojmë shkatërrimin e parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbëra.

Shqipëria po përjeton një situatë tepër skandaloze dhe të rezikshme.

Shumica e makinave në vendin tonë e ka kaluar moshën 15 vjecare dhe kjo duket nga bloza dhe tymi i zi që ato clirojne cdo ditë nëpër rrugët e qyteteve tona. Duhet ti themi ndal qarkullimit të këtyre automjeteve në rrugët tona.Shqipëria duket të ketë treguesit europian të ndotjes dhe jo të jetë vëndi më i ndotur në Europë.

Misioni i Të Gjëlberve është ti përgjigjen politikisht krizave ekologjike për të krijuar mjedisin e afërt joshës, ku fëmijët të kenë vend parësor.

Të krijojmë më shumë vende, për sport dhe kulturë, sidomos për të rinjtë.

Ne dëshirojmë të kemi qytete dhe qendra plotë gjallëri,ku cilësia e jetës është e lartë, të gjelbëra dhe me pemë anas rrugëve.

## **3. Për të mirën e fëmijëve**

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për një jetë me dashuri, respekt dhe pa u diskriminuar. Çdo fëmijë duhet parë dhe duhet të ketë mundësi të zhvillohet, duke u nisur nga parakushtet që ai ka.

Cdo fëmijë ka të drejtë të gëzoj një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Ne jemi për përfshirjen e konventën së fëmijëve të OKB në ligjin

Shqiptar

#### **4.Më shumë ushqim ekologjik**

Ne dëshirojmë heqjen e tvsh-s për ushqim ekologjik, dhe ta orientojmë bujqësinë Shqiptare në prodhimin ekologjik.

Ne dëshirojmë ta shtojmë blerjen e ushqimit ekologjik si dhe të ushqimeve të prodhuara në afërsi, për t'ua lehtësuar tregjeve lokale. Fushat Shqiptare dhe tregjet e fruta-perimev nuk duhet të përmbajnë prodhimet me gjene të modifikuara.

#### **5. Trafik më të mirë kolektiv**

Nevojat e transportit duhet të zvogëlohen, transporti i mallrave të bëhet përmes hekurudhës, Trafiku me autobus dhe tren duhet të përmirësohet në tërë vendin. Duhet të ketë një përkrahje të veçantë për trafikun kolektiv në vendbanimet jo fort të populluara. Ne dëshirojmë të investojmë në trafikun hekurudhor, në vend që të ndërtohen autostrada të shtrenjta, si dhe rrugë të tjera rreth e përçark.

Ne duhet të përmirësojnë mjedisin dhe trafikun kolektiv. Ne dëshirojmë të kemi tarifa/çmime të ulëta për trafikun kolektiv.

#### **6. Më shumë vetura mjedisi/që nuk ndotin mjedisin**

Ne dëshirojmë që në rrugët tona të ketë vetura më efikase dhe që harxhojnë më pak karburant. Më së largu më 2020 duhet të gjitha veturat e reja që futen ne Shqipëri mund punojnë me ndonjë karburant të ripërtëritur.

Ne dëshirojmë të mbështesim që veturat ekzistuese të rindryshohen dhe ato të punojnë me karburant mjedisi/që nuk e ndotin mjedisin.

## **7. Për energji të ripërtëritur**

Zgjidhjet e zgjuara dhe te efektshme të energjisë, duhet të mbështeten. Duhet të vihen në planet e ardhëshme të investimeve të jetë ajo e prodhimit të rrymës nga era. Ne dëshirojmë të kemi panele diellore në shumicën e pallateve në vitin 2020. Tatimi i pasurisë së paluajtshme, duhet t'i favorizoj investimet e banimit, në favor të mjedisit. Ne duhet të ndërtojmë shtëpi që të harxhojnë sa më pak energji. Ne dëshirojmë të investojmë, në karburantet e brendshme/të vendit të cilat janë më të mira për mjedisin, si dhe në energjinë e ripërtëritjes. Energjia bërthamore as që duhet marrë në konsideratë.

## **8. Për një shëndet më të mire**

Ne dëshirojmë të nxisim investimet për kujdesin shëndetësor dhe kujdesin parandalues. Politika shëndetësore do të jetë prioritare. Kujdesi duhet të jetë i barabartë dhe të jetë afër qytetarëve. Rritja e investime në këtë fushë janë është e nevojshme. Mjekësia alternative dhe ajo shtesë, duhet të integrohet në kujdesin shëndetësor dhe atë mjekësor.

## **9. Për një shtet social**

Ne jemi për një shoqëri humane dhe mbrojtje sociale, që synon zhdukjen e varfërisë, shtimin e vëndeve të punës, përmirësimin e shërbimeve të strehimit dhe ngritjen cilësore të jetës së popullit. Sigurimi i një niveli minimum të ardhurash për çdo shtetas nëpërmjet skemës së asistencës sociale ose pagës minimale, ose një kombinim i të gjithë koncepte të mësipërme.

Ne dëshirojmë ta përmirësojmë sigurimin social. Ne dëshirojmë të mbështesim njerëzit në nevojë. Të gjithë kanë të drejtën të gëzojnë një minimum jetik.

Ne duhet të krijojmë të reja pune në sektorin publik.

Ka nevojë edhe për më shumë hapësirë, dhe më shumë të punësuar në sektorin publik.

Ne shohim një nevojë të veçantë, në aspektin e kulturës, shkollës, kujdesit mjekësor, kujdesit për pleqtë si dhe veprimtarisë parashkollore.

## **10. Mbrojtje e të drejtave të grave**

Në botën e punës, gratë janë akoma minoritare, janë akoma me pak të paguara se burrat me të njëjtin nivel kualifikimi.

Si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, punëdhënësit duhet të marrin përgjegjësinë e tyre për pagat e barabarta duke i hequr dallimet e pagave, lidhur me gjnitetë

Të gjithë ato që i nënshtrohen dhunës ose kërcënohen, nga të afërmit, duhet të kenë një banim të sigurt.

Trajtimi i drejtësisë duhet të jetë profesional dhe me respekt të plotë në marrëdhëniet e të njëjtës gjini, duhet përcjellur me vëmendje.

Diskriminimi në bazë seksi në të gjitha sferat e jetës kulturore dhe shoqërore duhet të jetë i ndaluar.

Duhet të kemi aksione pozitive për pjesëmarrjen e gruas në fusha publike dhe private derisa të dy sekset të arrijnë barazinë.

Masat që sigurojnë pjesëmarrjen e barabartë në të gjitha fushat lidhur me kujdesin duhet të gjenerohen.

## **11. Orar më të shkurtër të punës dhe një jetë më të sigurt në punë**

Ne dëshirojmë të ulim orarin e punës të rregulluar me ligj në 35 orë në javë.

E drejta për ta drejtuar vetë, se a do të punosh me orar të plotë apo gjysmë orari pune, duhet të forcohet.

Marrëveshjet kolektive duhet mbrojtur, në mes tjerash, për ta luftuar uljen e pagave.

Angazhimi për mjedisin duhet të forcohet, për ta parandaluar problemet shëndetësore

## **12. E drejta për një pleqëri të sigurtë**

Veprimtaria mbështetëse, ku të moshuarit dhe të rinjtë ndihmojnë njëri tjetrin, duhet të zhvillohet. Të moshuarit duhet të kenë ndikim më të madh mbi format e kujdesit për ta, dhe të thyhet vetmia.

Ka nevojë për më shumë azile për të moshuarit si dhe për alternativa tjera banimi.

Pensioni i garantuar duhet të rritet dhe kujdesi mjekësor për ata me aftësi të kufizuar. Na duhen më shumë burime mbështetëse.

## **13.E drejta për një banesë**

Të gjithë kanë të drejtë të kenë një banesë. Për t'u dhënë mundësi atyre, të cilët janë të pa strehë dhe të kthehen në një jetë të përshtatshme dhe normale, ka nevojë për më shumë forma banimi përshtatur sipas individit, parë si nga aspekti ekonomik ashtu edhe nga aspekti social. Rrjetet e reja sociale në lidhje me banesën, janë kushte të rëndësishme. Duhet ndjekur një politikë ambicioze për banimin social

## **14. Mundësi financiare për kujdesin shëndetësor**

Ne dëshirojmë të aplikojmë një sigurim të përgjithshëm shëndetësor dhe vecanrishtë atë dentar, që shpie në shpenzime më të ulëta për pacientët, si dhe sjell një shëndet më të mirë .

Duhet të forcohet perspektiva parandaluese mbështetëse për shëndetin.

Ne dëshirojmë ta forcojmë më shumë kujdesin për shëndetin duke siguruar një listë shërbimesh falas për të gjithë pamvarësisht nga mosha.

## **15. Ruajtja e gjithëanshmëri biologjike**

Proçeset e natyrës janë të kërcënuara nga aktiviteti njerëzor. Për ta parandaluar këtë fenomen ne mendojmë se nevojitet hartimi i një kuadri ligjor që do të bënte të mundur ndalimin e varfërimit të burimeve të natyrës si një çështje me interes të përgjithshëm. Ruajtja e florës e faunës dhe shumëllojshmëria e llojeve janë prioritet të politikave tona.

Veprimtaria njerëzore duhet bërë duke pasur parasysh natyrën, ashtu që gjithanshmëria e llojeve, të ruhet dhe të zhvillohet. Shqipëria duhet të kujdesit për ruajtjen e shumëllojshmërisë së kafshëve, shpendët dhe peshqit.

Livadhet dhe kullosat me lloje të pasura duhet mbrojtur. Mbrojtja e plazheve nuk duhet të lihet pas dore.

## **16. Kushte më të mira për Edukim**

Ne jemi për një politike arsimore përparimtare dhe të hapur ku të gjithë nxenesit që mbarojnë shkollën e mesme të kenë të drejtë të vazhdojnë shollën e lartë. Ne jemi për forcimin e shkollës.

Të Gjithë të kenë të drejtë të mbarojnë maturën pamvarësisht nga mosha që kanë.

Të Gjithë studentet apo nxenesit që kanë lenë përgjysëm studimet të kenë të drejtë t'i vazhdojnë ato në një kohë tjetër pamvarësisht nga mosha e tyre.

Për një sistem me pagese që i lejon secilit për të patur një ose më shumë diploma, duke u rikthyer në shkollë gjatë gjithë jetës nese ai e dëshiron kete.

Një politikë paisjesh ambicioze për të lejuar futjen e handikapeve në shkollë.

Rritjen e bursave të studimit për një gamë më të gjerë studentesh të cilet nuk ndjekin dot studimet për shkak të gjëndjes ekonomike që kanë.

Ndikimi i nxënësve dhe mundësia e tyre për të ndikuar, duhet të forcohet. Të gjithë mësuesit, në rend të parë mësuesit e parashkollores, duhet të ndjekin një arsimim me temë, barazinë.

Ne dëshirojmë që shkolla të ketë më shumë në qendër të vëmendjes njohuritë afatgjate, prandaj ne dëshirojmë të kemi një alternativë për sistemin e sotëm të notave.

## **17. Demokraci pjesëmarrëse**

Qytetarët duhet të kenë më shumë mundësi për të ndikuar në vendimet politike.

Qytetarët duhet të kenë mundësi të paraqesin propozimet e veta, në të gjitha komunat dhe këshillat e tyre si dhe këshillat e qarkut.

Duhet të aplikohet e drejta e iniciativës nga ana e qytetarëve për referendume.

Mosha me të drejtë vote të ulet nën 18 vjet.

## **18. Forcimi i së drejtës**

Ne dëshirojmë t' u ofrojmë qytetarëve të drejta më të mëdha në krahasim me shërbimet publike, si kujdesin mjekësor, shkollë, universitet, kujdes për fëmijë si dhe kujdes për të moshuarit.

Ne dëshirojmë, po ashtu, të punojmë me marrëveshje qytetare, në sferën e shërbimit publik, ashtu që niveli i shërbimeve të jetë një e drejtë qytetare, për çka mund të kërkohet përgjegjësi, me të drejtë kompensimi për shërbimin e pa kryer.

**NE DËSHIROJMË TË NDËRTOJMË**

**NJË SHQIPËRI TË GJELBËR**

**NËSE DHE JU DONI**

**MIRËSE TE VINI TE NE**

**BASHKARISHT DO T'JA DALIM**